



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1491/2Prot.

Pukë, me 04.09.2025

V E N D I M

Nr. 30, datë 04.09.2025

“Per miratimin e projektit me objekt: “Masa parandaluese te gerryerjes se tokave bujqesore nga ujrat e larta dhe sistemimi i tyre Fshati Gomsiqe Njesia Administrative Qerret Bashkia Puke ” me fondin e kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile”

Bazueshmëria ligjore e P/ Vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30 shkronja “gj”, VKM nr. 414 date 08.07.2021 “Per miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes dhe te perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile , i ndryshuar me VKM nr. 290 date 17.05.2023, shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.492/1 Prot date 25.02.2025 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

Për sa më sipër, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria e Finances si dhe Kryetari i Bashkisë Puke për të marrë masa parandaluese,te gerryerjes se tokave bujqesore nga ujrat e larta dhe rehabilitimi i tyre Fshati Gomsiqe Njesia Administrative Qerret Bashkia Puke , i propozon Këshillit Bashkiak , i ci pas shqyrtimit :

V E N D O S I :

1. Të miratojë Projektin me objekt: “Masa Parandaluese te gerryerjes se tokave bujqesore nga ujrat e larta dhe sistemimi i tyre Fshati Gomsiqe Njesia Administrative Qerret Bashkia Puke ” nga fondi i Kushtezuar i buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile më vlerë: 1198977.64 **leke** , me kod produkti 91707AG , sipas shkreses nr.492/1 prot . 25.02.2025 ”Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances , Sektori i Emergjencave Civile
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).
4. Vendimi u shpall me date 04.09.2025
Vota te vlefshme gjithsej 10
Vota pro 9 , Vota kunder 0 , Vota abstenim 1

SEKRETARI
Hazbi Terbuni

KRYETARI
Gjon GJOKA

22.09.25

H. Tereshe
F. Jafar
B. Ademi
Eni
A. J. J.



1491/4
22.09.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Shkodër, më 13.09.2025

Nr. 530/1
prot.

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 30, datë 04.09.2025 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe Aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 27/1, neni 29, pika 1, neni 37, pika 1, shkronja "c", neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 3, pika 13, neni 22, pika 3, neni 27, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, shkronja "f", "gj", neni 41, pika 1, 2, të VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuara të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, pika 3.1, shkronjat "b", "gj", të shkresës së AKMC nr. 492/1 prot., datë 25.02.2025 "Mbi fondin e kushtëzuar të shtetit për mbrojtjen civile", të VKB Pukë Nr. 64/2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027", të ndryshuar, të shkresës së Këshillit të Bashkiak Nr.1482/4 prot., datë 08.09.2025 "Mbi dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Pukë", shqyrtoi VKB Pukë Nr. 30, datë 04.09.2025 "Për përdorim të fondit të kushtëzuar me kod 91707AG¹ për marrjen e masave parandaluese të gërryerjes së tokave bujqësore nga ujrat e larta dhe sistemim të tyre në fshatin Gomsiqe, NJAD Qerret në vlerën prej 1.198.977.64 lekë miratuar me VKB Pukë Nr. 64/2024".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Ju sqarohet se nuk është tagër i KB të miratojë një projekt në një fushë të tillë specifike, i përgatitur nga një inxhinier i licensuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI



¹ Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese